



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: @avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501292/7

Tiranë ___/___/2015

Lënda: Rekomandohet *"Fillimi i hetimit për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare"* ndaj shtetasit E. A., ish shef i Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë dhe *"Mosmarrja e masave për ndërprerjen e gjëndjes së paligjshme"* në ngarkim të punonjësve të policisë G. J., e B. P., parashikuar përkatësisht nga nenet 250 dhe 251 e 25 të Kodit Penal".

Drejtuar : Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor
Z.Petrit FUSHA

TIRANË

Për dijeni: Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

TIRANË

I nderuar Z. FUSHA,

Avokati i Popullit më datën 30.07.2015, pasi ka urdhëruar kryerjen e inspektimit në Komisarariat e Policisë nr.2 Tiranë, ka ndërmarrë një hetim të pavarur administrativ lidhur me konstatimin për keqtratjim nga Policia e Shtetit, të shtetasve M. C., dhe R. K.

Në vijim të hetimit administrativ janë kryer një sërë veprimesh të cilat kanë konsistuar në marrjen e shpjegimeve të shtetasve të dëmtuar M. C., e R. K.; punonjësve të policisë të cilët kanë përpiluar dokumentet për personat e shoqëruar si, G. J., etj; janë administruar kopje të fletëve të librit për personat e shoqëruar dhe marrjen në pyetje nga punonjësit e policisë; grafia e nofullës

dhe gjoksit për dëmtimet e shkaktuara shtetasit M. C., si dhe akti i ekspertimit mjeko ligjor nr.1303 datë 08.07.2015.

Nga hetimi administrativ i kryer rezultoi se:

Rrethanat e ngjarjes

Shtetasi M. C., banon në qytetin e Tiranës dhe kryen detyrën e menaxherit në lokalit "SOHO bar", i cili ndodhet në afërsi të Pallatit të Sportit "Asllan Rusi". Në këtë lokal punon si kamarjer dhe shtetasi R. K.

Në ditën e ngjarjes datë 29 Qershor 2015, rreth orës 21.00 shtetasit M. C., dhe R. K., kanë qënë në punë turni i dytë, kur në afërsi të lokalit kanë shkuar punonjës të policisë së Komisarariatit nr.2, me tre mjete policie. Në lokal kanë hyrë z. Q. D., ish shef i rendit dhe Specialisti i Policisë së Zonës B. P.

Pasi ka marrë kontakt me menaxherin e lokalit M. C., shefi i rendit Q. D., i ka komunikuar atij urdhërin e shefit të Komisarariatit të Policisë për të mbyllur lokalit dhe shoqëruar në Polici të gjithë punonjësit e tij. Duke parë se lokali kishte shumë klientë, shefi i rendit Q. D., ka sqaruar shtetasin M. C., që të vinte në Polici bashkë me një nga kamarjerët. Kështu, në Komisariatin e Policisë kanë shkuar M. C., dhe R. K., në mjetin e policisë që drejtohej nga shefi i rendit, ndërsa brënda në të ndodheshin Specialistët e Policisë së Zonës, G. J., e B. P.

Në Komisariatin e Policisë, nga Specialistët e Policisë së Zonës, të shoqëruarit janë sqaruar se aryesja e shoqërimit të tyre ishte për t'u pyetur si persona që mund të kishin dijeni lidhur me ndodhjen e shtetasit F. K., (kunati i shtetasit M. C.,) person i shpallur në kërkim policor, pasi kishte ndërtuar tek lokali në mënyrë të paligjshme duke zaptuar hapësira publike. Mandej punonjësit e policisë kanë plotësuar dokumentacionin përkatës për personat e shoqëruar duke i vendosur ata tek dhoma e shoqërimit.

Veprimet e kryera

Baza për fillimin e procedimit penal

Në shpjegimet e tij shtetasi M. C., ka sqaruar se: *"... pas 30 minutash, kur Specialistët e Policisë së Zonës G. J., e B. P., kanë përfunduar formalitetet e dokumentacionit, në zyrë ka ardhur shefi i Komisarariatit E. A., i cili e ka pyetur se ku ndodhej kunati i tij F. K., dhe pasi ka marrë përgjigje se nuk kishte dijeni, e ka qëlluar me forcë me grushte në fytyrë tek nofulla e dhjathhtë, duke hequr njërin dhëmb".* Ushtrimi i dhunës nga shefi i Komisarariatit të Policisë ndaj shtetasit M. C., ka vazhduar për 10-15 minuta dhe në pjesë të tjera të trupit sidomos nga gjoksi. në prani të shtetasit R. K., dhe punonjësve të policisë G. J., e B. P. Më pas, shtetasi M. C., është çuar në dhomën e shoqërimit dhe në orët e para të mëngjezit të datës 30 Qershor 2015, nga Policia Gjyqësore i janë marrë deklarime si person që ka dijeni për rrethana të hetimit.

Shtetasi R. K., në shpjegimet e tij ka sqaruar se: *"si unë ashtu dhe M., i thamë shefit të Komisarariatit se nuk e njihnim personin me emrin F., dhe pas kësaj ai ka goditur M., me grusht në fillim tek nofulla pastaj nga brinjët, ndërsa mua më ka goditur me grusht prapa koke ndonëse përpiqesha të mbrohesha me duar....kam dijeni që pas rreth 1 ore që na çuan tek dhoma e shoqërimit, kanë marrë M., dhe e kanë çuar në një zyrë ku dhe e kanë pyetur, por se kush dhe*

për çfarë nuk e di. M., është kthyer tek dhoma e shoqërimit pas rreth 20 minutash dhe më tha se shefi Komisarariatit e kishte qëlluar përsëri me grushte nga brinjët”.

Shtetasi Q. D., me detyrë ish shef i rendit në Komisarariatit e Policisë nr.2 Tiranë, në shpjegimet e tij të datës 21 Korrik 2015, ndërmjet të tjerave sqaron se: “... Mbjaj mend që doli një djalë me bluzë të zezë, i cili më tha se ishte menaxheri i lokalit, për të cilin mësova më vonë se quhej M. C. I komunikova se më është dhënë urdhër nga shefi i Komisarariatit që të mbyllej lokali e të shoqëroj të gjithë personelin në Komisarariat, por meqënëse lokali ishte plot me njerëz, i thashë që ju bashkë me kamarjerin të vini në Komisarariat”.

Shtetasi B. P., me detyrë Specialist i Policisë së Zonës, në shpjegimet e tij të datës 22 Korrik 2015, ndërmjet të tjerave sqaron se: “...kam qënë i pranishëm kur oficerja e Policisë Gjyqësore A. P., ka marrë deklaratimet e M., R., dhe motrës së M., që quhet A. K., bashkëshortja e F. M., u shpreh që ishte rrahur në Komisarariat, në sy të motrës së vet dhe tonën. Me sa pashë dhe M., dukej pak i skuqur nga fytyra”.

Në aktin e ekspertimit mjeko ligjor nr.1303 datë 08.07.2015, ndërmjet të tjerave thuhet : “...nga ana e mjekut ekspert u rekomanduara ekzaminimi “Panoramex” dhe konsultë stomatologjike në të cilën përshkruhet se nga vizita e kryer në klinikën dentare datë 08.07.2015, dhe nga ekzaminimi radiografik (panoramaex) evidentohet frakturë e nofullës së poshtme me ramus mandibulae sinistra dhe frakturë në sinusin etmoidal.” Mandej arrihet në një konkluzion duke u shprehur se : “ në konsulencë me mjek specialist pranë departamentit të Stomatologjisë Universitare nuk evidentohen dëmtime të nofullës së poshtme dhe mungesa e dhëmbit referuar si thyerja nga ana e shtetasit M. C., rezulton se nuk ka lidhje me ngjarjen e referuar nga ana e tij, por me patologji dentare”. Në konkluzion sipas ekspertit mjeko ligjor Dr.Elmaz Shaqiri, tek shtetasi M. C., nuk u konstatuan dëmtime të jashtme trupore në ekzaminimin e tij të jashtëm objektiv të realizuar në ambulancën e Institutit të Mjekësisë Ligjore datë 08.07.2015. Në ekzaminimet radiografike të gjoksit dhe të nofullave të interpretuar nga mjek imazherist në Departamentin e Imazherisë pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë, nuk u evidentuan thyerje të nofullave apo të brinjëve”.

Shprehim mendimin se konkluzioni i dhënë nga eksperti mjeko ligjor, është i nxituar dhe bie ndesh jo vetëm me faktin e konstatimit të frakturës së nofullës së shtetasit M. C., por dhe në kontekst me aktet e administruara në dosjen e rastit. Si i tillë ai duhet t’i nënshtrohet kryerjes së një ekspertimi tjetër me grup ekspertësh mjeko ligjorë dhe specialistë të fushës.

Në “Rregjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, që disponon Komisarariatit i Policisë nr.2 Tiranë, është pasqyruar shtetasi M., K. C., i shoqëruar në datën 29 Qershor 2015, ora 21.30 dhe lënë i lirë datë 30.06.2015, ora 05.00. Në të njëjtën datë dhe orë është shoqëruar dhe shtetasi tejtër R., M. K., kurse arsyeja e shoqërimit të dy shtetasve ka qënë “ *Dyshuar se kanë dijeni për person në kërkim*”

Tek libri ku evidentohen “Marrja në pyetje e personave të ndaluar/arrestuar apo të thirrur në Polici”, (bashkëlidhur kopje e fletës së librit) nga punonjësi i policisë F. H., janë pasqyruar ora e nxjerrjes nga dhoma e shoqërimit, punonjësit e

policisë që kanë çuar të shoqëruarit M. C., dhe R., K., në zyrat e Komisarariatit të Policisë dhe personat që kanë marrë ata në pyetje.

Kështu, rezulton se më datën 29.06.2015, nga ora 22.20 deri në orën 22.45 shtetasi M. C., është shoqëruar nga punonjësi i policisë B. P.; nga ora 23.35 deri në orën 0.20 nga punonjësi i policisë me kodin 53/21. Në datën 30 Qershor 2015, nga ora 0.27 deri në orën 0.32 nga punonjësi i policisë G. J.; nga ora 01.12 deri në orën 01.52 shoqëruar nga punonjësi i policisë B. P.; nga ora 02.50 deri në orën 02.55 dhe nga ora 0.400 deri në orën 04.30 shoqëruar nga punonjësi i policisë me kodin 45 (shefi i krimeve).

Sa i përket shtetasit R. K., në libri ku evidentohen personat e marrë në pyetje, konstatohet data 30.06.2015, nga ora 04.30 deri në orën 04.55, i pyetur nga oficerja e Policisë Gjyqësore A. P.

Mendime dhe përfundime

Parë në tërësi veprimet e kryera nga punonjësit e policisë të Komisarariatit nr.2 Tiranë, janë të parregullta dhe bien ndesh me dispozitat përkatëse për rastet e “njoftimit për paraqitje në polici”, parashikuar në pikën 2 të nenit 108 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet : *“Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletë thirrjes, duke përcaktuar arsyen e paraqitjes, të dhëna për punonjësin e policisë, kohën, vëndin dhe informacion për ta kontaktuar punonjësin e policisë në rast pamundësie për t’u paraqitur”*. Kjo për faktin se shtetasit M. C., dhe R. K., nga Policia Gjyqësore do të pyeteshin nëse kishin dijeni për vëndndodhjen e shtetasit F. K., person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Ndërtim i paligjshëm”, për të cilën Komisarati i Policisë nr.2, më datë 29.06.2015, materialet hetimore procedurale i ka referuar për ndjekje Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më datën 08.07.2015, shtetasit R. K., e M. C., janë paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe iu janë marrë shpjegime për ngjarjen e ndodhur. Duke parë gjëndjen jo të mirë shëndetësore të shtetasit M. C., ai është dërguar për vizitë dhe kryerjen e grafisë së nofullës në një klinikë private dhe mbi bazën e kërkesës së Avokatit të Popullit për kryerjen e ekspertimit mjeko- ligjor është dërguar për ekzaminim mjeko ligjor pranë IML Tiranë.

Duke analizuar në tërësi ngjarjen me provat e administruara rezultoi se:

Së pari: Ish shefi i Komisarariatit të Policisë E. A., pasi mori dijeni për kryerjen e veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm” ka urdhëruar kryerjen e veprimeve procedurale hetimore si, gjetjen e të dyshuarit F. K., dhe pyetjen e personave që kanë dijeni për ndodhjen e tij.

Por, nga ana tjetër ai në mënyrë abuzive dhe arbitrare urdhëron ish shefin e rendit Q. D., që të mbyllet lokalit dhe të shoqërohen në Polici të gjithë punonjësit e tij. Ky urdhër i kundërligjshëm nuk është zbatuar nga shefi i rendit, i cili pasi kanë informuar menaxherin e lokalit M. C., me urdhërin e mësipërm, me profesionalizëm e sjellje korrekte e kanë sqaruar atë që të vinte në Polici bashkë me një kamarjer. Shtetasit M. C., dhe R. K., kanë mirëkuptuar punonjësit e policisë dhe në mënyrë korrekte janë shoqëruar me mjetin e policisë në mjediset e Komisarariatit.

Trajtimi në Polici i shtetasve M. C., dhe R. K., në cilësinë e personave të shoqëruar nuk është korrekt dhe bie në kundërshtim me nenin 105 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i cili bën fjalë për “personat e shoqëruar në Polici”. Këta shtetas duhet të trajtoheshin si persona të thirrur për dënimin e një vepre penale, dhe si të tillë duhet të mbaheshin në zyra të Komisarariatit dhe jo në dhomë shoqërimi me derë të mbyllur dhe me dritë nga jashtë, çka edhe kjo përbën një veprim arbitrar.

Mungesa e profesionalizmit dhe veprimet abusive vazhdojnë në thirrjen e shtetasve M. C., dhe R. K., disa herë për t'u marrë në pyetje gjatë orëve të natës së datës 29 Qershor deri në orën 0.5.00 të datës 30 Qershor 2015, kohë që edhe i kanë lënë të lirë, duke pasqyruar në proces verbalët përkatëse se: *“nuk kam pretendime në lidhje me shoqërimin dhe intervistimin që më është bërë nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë nr.2 Tiranë”*.

Por, kulmi i veprimeve abuzive dhe arbitrare është ushtrimi i dhunës fizike nga shefi i Komisarariatit të Policisë E. A., i cili ka qëlluar me grushte në pjesë të ndryshme të trupit shtetasit M. C., dhe R. K., me qëllim për të mësuar prej tyre vëndodhjen e shtetasit F. K., person i kërkuar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”. Kryerja e këtyre veprimeve në mjediset e Policisë gjatë ushtrimit të detyrës i kapërcen kompetencat dhe si e tillë është e kundërligjshme me pasoja në shëndetin e qytetarëve dhe cënimin e dinjitetit njerëzor.

Këto veprime bien ndesh me Misionin e Policisë së Shtetit, që është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, parashikuar në nenin 2 të ligjit nr.108/2014.

Shteti i ka dhënë Policisë përgjegjësi për kryerjen e shërbimeve të policimit në respekt të shtetit ligjor. Prandaj dhe shërbimet policore duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, llogari dhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Nëpërmjet dhënies së urdhërave arbitrare si dhe kryerjes flagrante të veprimeve arbitrare të dhunshme, nga shefi i Komisarariatit të Policisë E. A., gjatë ushtrimit të detyrës, ka dyshime të arsyeshme e të bazuara se ai ka kryer vepra penale e “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.

Së dyti: Hetimi administrativ i kryer, sqaroi dhe faktin se shefi i Komisarariatit të Policisë E. A., dhunën fizike ndaj shtetasve M. C., dhe R. K., e ka ushtruar në praninë e punonjësve të policisë G. J., dhe B. Pasho.

Ka qënë detyrimi tyre, duhet që t'i kërkonin personit kompetent E. A., edhe pse kryente detyrën e shefit të Komisarariatit të Policisë, që të ndërpriste gjëndjen e paligjshme si rezultat i veprimit arbitrar që po cënonte në mënyrë të dukshme lirinë e shtetasve, apo të merrnin masat e nevojshme për mosvazhdimin e saj. Më konkretisht, ndërsa nga ana e ish shefit të Komisarariatit të Policisë E. A., po shkelej ligji dhe po prekej liria e shtetasve nga veprimi arbitrar i kryer, prej punonjësve të policisë nuk u ndërmorr asnjë masë për t'i dhënë fund gjëndjes së paligjshme, çka dhe krijon bazën juridike për veprën penale të *“Mosmarrjes së masave për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme”*, parashikuar nga neni 251 i Kodit Penal.

Objekti i veprave penale të mësipërme janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të rregulluar veprimtarinë e rregullt shtetërore ose shërbimin publik që kanë të bëjnë me respektimin e lirive të shtetasve, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Për zhvillimin e një hetimi të gjithanshëm dhe objektiv, do të sugjeronimin:

a.Kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor me grup ekspertësh të IML-së, për të sheshuar kontradiktat në dhënien e konkluzionit të aktit mjeko ligjor nr.1303 datë 08.07.2015, referuar dhe akteve të administruara në dosjen e rastit nr.1292 të vitit 2015 (bashkëlidhur fotokopje të tyre).

b.Megjithë ftesën për paraqitje të shtetasit E. A., për të dhënë shpjegime në Institucionin e Avokatit të Popullit, një veprim i tillë nuk është realizuar për arsye të mosardhjes së tij. Për rrjedhojë, nga ana e organit procedues duhet të konkludohet lidhur me pozitën në procedimin penal të shtetasit E. A., dhe kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale.

c.Të hetohet në drejtim të veprimeve hetimore të kryera nga Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë, gjatë marrjes së deklarimeve të shtetasve M. C., dhe R. K., etj, në orët e vona të natës, apo për dijeninë dhe konstatimin e dëmtimeve, si rezultat i dhunës fizike të ushtruar në mjediset e Policisë si dhe detyrimin për njoftimin e prokurorit të gatshëm.

Referuar nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë për “Kompetencën tokësore”, në interes të çështjes dhe kryerjes së një hetimi objektiv, do të sugjeronim për këtë qëllim Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor më të afërt, e cila do të çmohej nga Ju.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “ç” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”*.

REKOMANDOHET

“Fillimi i hetimit, për veprën penale *“Kryerja e veprimeve arbitrare”*, ndaj ish shefit të Komisarariatit të Policisë Nr.2 Tiranë, E. A., parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal dhe *“Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme”* në ngarkim të Specialistëve të Policisë së Zonës, G. J., dhe B. P., parashikuar nga neni 251 e 25 të Kodit Penal.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Proces verbal për marrjen e shpjegimeve të ankuesve M. C., dhe R. K., datë 08.07.12015.

2.Proces verbal i marrjes së shpjegimeve të personit që ka dijeni për rastin në shqyrtim të shtetasve G. J., dhe B. C., datë 20 Korrik 2015; shtetasit Q. D., datë

21 Korrik 2015; shtetasit B. P., datë 22 Korrik 2015 dhe shtetasit F. Sh., datë 23 Korrik 2015.

3.Kërkesa për kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor datë 08.07.2015 dhe akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr./1303 datë 08.07.2015.

4.Fletë nga rregjistri I personave të shoqëruar në Komisaratin e Policisë nr.2 Tiranë datë 29 Qershor 2015.

5.Fletë nga libri i evidentimit të marrjes në pyetje të personave të ndakluar/arrestuar apo thirrur në Polici, datë 29 -30 Qershor 2015.

6.Ftesë për paraqitje të shtetasit E. A., datë14.07.2015.

7.Shkresa "Kërkesë për informacion" drejtuar Komisaritatit të Policisë nr.2 Tiranë, datë 14.07.2015.

8.Shkresa "Prsëritet kërkesa për informacion" drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë", datë 20.07.2015

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Konc.&Dakt.P.A.
Tiranë më 28.07.2015

Igli TOTOZANI

Me porosi dhe në mungesë

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI